




09.09.2022  
01/1225



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E MALISHEVËS

APLIKACION PËR ANKAND

Data

08.08.2022

MALISHEVË

IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

EMRI ZYRTAR DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES

	Komuna Malishevë Komisioni Komunal për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, VENDIMI nr.02/318, dt.05.07.2022	Personi kontaktues : e-mail:	Komuna Malishevë  komuna.malisheve@rks-gov.net
Adresa	Rr "Gjergj Kastrioti " pn	Kodi postar	24000
Qyteti	Malishevë	Fax	
Telefoni	029-269-008	URL:	
e-mail	kkmalisheve@gmail.com komuna.malisheve@rks-gov.net		

ADRESA E SAKTË KU DUHET TË DORËZOHEN APLIKACIONI

Adresa e saktë për dorëzimin e aplikacioneve:

Komuna Malishevës Objekt i ri, Qendra për shërbim të qytetarëve -shkresorja e komunës

Data kur është përgatitur dhe shpallur -publikimi i Aplikacioni-t :

Malishevë më datë:08.08.2022

I. LËNDA E KONTRATËS

Dhënie në shfrytëzim e pronës publike në afat prej 15 vitesh të Stadiumit të Qytetit "Liman Gegaj" në Malishevë, pronë publike në emër të, KK- Malishevës.

PËRSHKRIMI I LËNDËS SË KONTRATËS

Termet dhe kushtet materiale, natyra, fushëveprimi, kuantiteti .

Lënda e kontratës është : Dhënie në shfrytëzim e pronës publike në afat prej 15 vitesh të Stadiumit të Qytetit në Malishevë, pronë publike në emër të, KK- Malishevës.

Prona gjendet në pjesën e zonës kadastrale Dragobil, nr.P-72310025-00223-666, në vendin e quajtur "Polanka -Golesh" në sipërfaqe prej, 27250 m<sup>2</sup>.

Në këtë ngastër momentalishtë është ndërtuar edhe Stadiumi i Qytetit "Liman Gegaj" në Malishevë, në pronësi publike të KK-Malishevës.

Baza Ligjore : Në bazë të nenit 4,5, neni 6 par.6.1 pika 1, neni 8 par.8.1 pika 1.1, neni 14 të Ligjit nr. 04/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dt.07.03.2019, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS NR.10/03 PRILL 2019, neni 5 par.1, neni 8,9 dhe neni 10, neni 17, 19, 20, 21 të Rregullores QRK nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/317 datë 05.07.2022, për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës nr.02/318, dt.05.07.2022.

**Kufizimet kohore për fillimin dhe/ose përfundimin e kontratës:**

- Oportari Ekonomik -personi juridik ( në tekstin e mëtejme Aplikuesi ) i cili shpërblehet me kontratë do të realizoi detyrat sipas qëllimit të shprehur me vendimine Kuvendit të Komunës së Malishevës ,nr.02/318, dt.05.07.2022, gjatë tërë afatit të realizimit të kontratës.
- Kontrata për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale do të jetë në një afat prej 15 vitesh sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

**I I. ÇMIMI BAZË PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË ANKANDIT PUBLIK :**

Sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevë, Vendimi nr.02/317, dt.05.07.2022, çmimi bazë për fillimin e ankandit publik do të jetë 4800.00 € për një vitë të marrjes në shfrytëzim, ndërsa për 15 vite do të jetë 72.000.00 € ndërsa ofertuesi që ofron ofertën më të lartë për komunën do të përzgjidhet.

**I I I. KËRKESAT PËR SUBJEKTET QË DORËZOJNË APLIKACIONIN**

**I I I.1.1.) Kërkesat për Dëshmitë dokumentuese të përshtatshmërisë:**

**I I I.1.2.) Kërkesat për dëshmi të dokumentuese të përshtatshmërisë ( për personin Juridik )**

1. Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit se Ju nuk jeni në vonesë për pagimin e tatimeve, ky vërtetim duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendrike nga data e hapjes së këtij aktiviteti, ) ( duhet dorëzohet nga aplikuesi të cilit synohet dhënia e kontratës )
2. Një vërtetim nga Administrata Komunale e vendit të personit mbi pagesën e tatimit në pronë..... ( kopje ).
3. Niveli garues i klubit-personit juridik që aplikon për të marrë në shfrytëzim pronën publike,
4. Niveli dhe renditja e klubit-personit juridik në nivel shtetëror, Superlig apo ligëne e parë, në RKS.
5. Struktura organizative e klubit-personit juridik, dëshmi për nivelin profesional të organizimit,
6. Numri i të punësuarëve në klub-personin juridik,
7. Niveli si dhe përfshirja e moshave në klub, personin juridik,
8. Kapacitetet njerëzore dhe profesionale, si dhe të arriturat në vitin e fundit të klubit në nivel shtetërorë.

### II I.1.3) Kërkohen dëshmi të dokumentuara mbi përshtatshmërinë profesionale:

#### Për personin juridik :

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e themelimit të operatorit ekonomik. ( Certifikata e rexhstrimit të biznesit ) ( e kompletuar ) ..... ( kopje )
2. Certifikata e numrit fiskal ( valide ), të dorëzohet në ..... ( kopje )
3. Letërnjoftimi valid i themeluesit të Op.Ek. , të dorëzohet në ..... ( kopje )
4. Një Deklaratë e shkruar dhe nënshkruar në të cilën, aplikuesi, Autoritetin Kontraktues e sqaron mbi qëllimin dhe aktivitetin ekonomik që do ta ushtroi në pronën komunale për të cilën ka dorëzuar oferten , të dorëzohet në ..... ( Original )
5. Përparsi do të kenë, klubi apo personi juridik që vepronë ose ka vepruar në emër të Komunës së Malishevës, në nivel të Republikës së Kosovës, në kualifikime të ndryshme.

#### IV - KËRKESA PËR KUALIFIKIM

1. Aplikuesi, operatori ekonomik , mund të dorëzojnë vetëm një aplikacion, dhe nuk mund të bëjnë asnjë ndryshim në aplikacionin e pranuar.

#### 2. V - KUSHTET E KONKURIMIT

1. Çmimi fillestar i qirasë paguhet, jo më largë së deri më me datë, 01.01.2023 për vitin e parë) dhe i njëjti parim do të aplikohet edhe për vitin pasues, jo më largë se javën e parë të muajit janar, për secilin vit vijues deri në vitin e fundit, përkatësisht deri në vitin 2037.
2. Në rast të mos respektimit të këtij kriteri komuna mbanë të drejtën e shkëputjes së njëanshme të kontratës dhe do të përzgjedhë ofertuesin e dyt i cil ika çmim më të lartë të ofruar në ankand.
3. Afati i dhënies në shfrytëzim të përkohshëm të pronës është 15 vite.
4. Të gjitha shpenzimet e përgatitjes së stadiumit, përveq gjendjes ekzistuese me qëllim të shfrytëzimit të hapësirave të mbrenshme, si rrjeti elektrik, ujit dhe shpenzimet tjera të paparashikuar bien në barrë të përfituesit të përkohshëm të pronës.
5. Komuna, në rast nevoje për interes publik, rezervon të drejtën e shkëputjes së njëanshme të kontratës me përfituesin e përkohshëm të pronës, pa obligim të kompensimit të investimeve të bëra. Gjitha investimet e bëra, mundë të tërhiqen nga investitori – përfituesi i përkohshëm i pronës, në afatin e përcaktuar nga komuna.
6. Komuna, 3 ( tre ) muaj para ndërprerjes së kontratës, do ta njoftojë me shkrim secilin shfrytëzues të përkohshëm, në rast të ndonjë vendimi që do të ndërlidhet me pikën 4 të Kushteve të Konkurimit.
7. Veprimtaria e deklaruar me shkrim prej aplikuesit përfitues nuk mundë të ndërrohet pa pëlqimin paraprak të organi kompetent të komunës në Malishevë.
8. Mbikqyrja do të bëhet nga inspektorati i komunës dhe drejtoria për kulturë, rini dhe sport, duke bërë raport me shkrim në lidhje me ecurin e kontratës, dhe me të njëjtin duhet të njoftojë kryetarin e komunës.
9. Është e ndaluar rreptësisht dhënia tjetrit me qera të pronës – objektit. Mosrespektimi i këtij kushti paraqet bazë për ndërprerjen e menjëhershme dhe të njëanshme të kontratës.

## V I. INFORMATAT SHITESË

### KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË

Mundë të merrni informata plotësuese, përmes kërkesës me shkrim, deri më

dt. 20.08.2022.

DUKE MARRË PARASYSH SE [Personi Juridik ] (më tej " APLIKUESI "), pas pranimit të aplikacionit nën Nr. e dokumentit të sipër-përmendur, beson se nevojiten informacionet shtesë ose informacionet sqaruese si në vijim:

Identifikimi i informacioneve shtesë ose i informacioneve sqaruese, përfshirë referimet në pjesën apo në pjesët e dosjes së ankandit:

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Personin Juridik, nëpërmjet kësaj kërkoj marrjen e informacioneve të identifikuar.

Identifikimi i aplikuesit – Personit Juridik	
Emri aplikuesit :	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

## VII. AFATI KOHOR DHE VENDI PËR DORËZIMIN E APLIKACIONIT

Vulosja/Nënshkrimi dhe shënimi i Aplikacionit :

V I.1. -Aplikuesi duhet të përgatisë një origjinal të dokumenteve që përbëjnë aplikacionin-tenderin dhe në mënyrë të qartë të shënojë atë "ORIGJINAL." Përveç kësaj,

-Aplikuesi duhet të paraqesë një kopje të aplikacionit dhe në mënyrë të qartë shënojë aty "KOPJE".

V I.2. Aplikuesi duhet të vendosë aplikacionin origjinal dhe kopjen në zarf të veçantë dhe në anën e përparme të secilit zarf do të:

1. Shënon qartë si "**Origjinal**" apo "**Kopje**";
2. Shënon numrin e Lëndës siç është e cekur në dosjen e aplikacionit;
3. Shënon emrin dhe adresën e Aplikuesit.

V I.3. Zarfet pastaj duhet të mbyllen në një zarf të jashtëm që tregon vetëm:

4. Adresën e vendit të dorëzimit të aplikacioneve;

5. Numrin e Lëndës;

6. Paralajmërim, se zarfi nuk guxon të hapet para datës dhe kohës së hapjes së aplikacionit; dhe

V I.4. Emrin dhe adresa e aplikuesit

#### AFATI KOHOR DHE VENDI PËR PRANIMIN E APLIKACIONIT-EVE

Data: 23.08.2022 Ora: 12:00 Vendi: Shkresorja e komunës në Malishevë

#### AFATI KOHOR DHE VENDI PËR HAPJEN E APLIKACIONIT-EVE

Data: 24.08.2022 Ora: 14.00 Vendi: Salla e Kuvendit Komunës Malishevë

*Aplikacionet që dorëzohet pas afatit të fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar, siç ceket më lartë në këtë paragraf, menjëherë do t'i kthehet e pa hapur, Operatorit Ekonomik – Aplikuesit.*

#### VALUTAT - LLOGARITJA E ÇMIMEVE

1. Të gjitha çmimet e specifikuar në aplikacion duhet të deklarohen në Euro (€) dhe duhet të përfshijnë dhe të specifikojnë të gjitha taksat dhe obligimet e aplikueshme sipas ligjeve në fuqi që e rregullojnë këtë çështje në Republikën e Kosovës. Të gjitha ngarkesat dhe / ose taksat e tjera komunale bien në barrë të Aplikuesit.
2. Çmimi i aprovuar dhe i kontraktuar nuk mundë të jetë objekt i rishikimit përgjat kohëzgjatjes së Kontratës, nga ky organ, por vetëm pasi kuvendi i Komunës i cili mund të nxjerrë vendim për ndryshimin e tij.

#### V I I I. PERIUDHA E VLEFSHMËRISË SË APLIKACIONIT

Detajet ofruara në Dokumentin e Aplikacionit do të jenë valid për 30 ditë kalendarike, nga data e fundit e dorëzimit të Aplikacionit.

Subjekti nuk mund ta tërheqë Aplikacionin e dorëzuar pas datës së fundit për dorëzim të Aplikacionit dhe para skadimit të periudhës 30 ditore.

#### I X. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS

*Kontrata do t'i jepet aplikuesit që ka dorëzuar Aplikacionin e kompletuar dhe që i ka plotësuar më së miri kushtet e lidhur me kërkesat për përshtatshmëri Formale – Administrative, Profesionale dhe Teknike, sikurse janë parashtruar në dokumentin për aplikim si dhe subjektit që ka ofruar ÇMIMIN MË TË LARTË.*

#### X. VLERËSIMI

Aplikacionet e pranuar me kohë do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në bazë të kërkesave të përcaktuara si më lartë.

Ofertuesi do të konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur:

- është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të këtij aplikacioni; dhe
- është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara si më lartë; dhe
- është dorëzuar nga operatori ekonomik - subjekti duke përmbushur kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara si më lartë.

Të qenit “në pajtueshmëri” nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e kërkesave dhe e specifikimeve administrative dhe teknike të parashtruara në këtë aplikacion, duke mos u larguar substancialisht nga to dhe duke mos i bashkangjitur atyre kufizimeve.

Nëse Aplikacioni nuk është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ dhe/ose teknik me Dokumentin e Aplikacionit, mundë do të refuzohet.

Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e Dokumentit të Aplikacionit, autoriteti kontraktues, nga secili Subjekt që dorëzon Aplikacionin individualisht, mundë të kërkoj sqarim mbi kushtet e shprehjes së interesit të tij/saj.

Kërkesa për sqarim dhe përgjigjja duhet të bëhen vetëm me shkrim, por nuk guxon të kërkohet, ofrohet ose lejohet asnjë ndryshim në çmim ose në ndonjë kusht ose aspekt material ose aspekt të Aplikacionit.

#### X I. ANKESAT

Pala e pakënaqur nga procesi final i vlerësimit të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit ka të drejtë të paraqes ankesë me shkrim, brenda afatin prej 15 ditësh nga data e marrjes së Njoftimit mbi rezultatin e vlerësimit dhe te vendosjes, Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave pran Komunës së Vushtrrisë, në pajtim me nenin 18 dhe 20 par.20.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të komunës.

Identifikimi i Personit Juridik	
Emri i personit Juridik-Fizik	
I përfaqësuar nga :	
Emri Mbiemri dhe telefoni	
Nënshkrimi	
Data	
Vula	

Komisioni Vlerësues:

1. Muharrem Morina- Kryetari i Komisionit.....
2. Amrush Helshani- Anëtar.....
3. Valon Krasniqi- Anëtar.....
4. Armend Krasniqi- Anëtar.....
5. Dibran Kastrati- Anëtar.....

Malishevë, më datë, 08.08.2022.